



Npi – 01/267 datë: 30.08.2022

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në mbledhjen e mbajtur më: 30.08.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT
E mbajtur më datën: 30.08.2022 (e martë) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, z.Hamëz Tërshani, z.Rexhep Gashi dhe znj.Arbenita Brahimi. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Reshat Gashi, zyrtar për drejtat e njeriu dhe barazi gjinore. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit; znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 08.07.2022,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KAKRS për vitin 2022,
3. Draft- Plani i punës të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022,
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, çdo gjë është në rregull, por te caktimi i orarit të mbledhjeve, unë propozoj që mbledhjet të thirren në ora 10:00h. e jo në ora 9:00h ashtu qysh është propozuar.

*** Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 08.07.2022

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, unë jam për dhe nuk kam ndonjë vërejtje për Procesverbalin.

*** Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 08.07.2022.**

Pika 2

Propozim-Vendim për caktimit të orarit të mbledhjeve të KAKRS për vitin 2022

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, datat janë në rregull, por unë propozoj që mbledhjet e Komiteti të mbahen në ora 10:00h. në vend të orës 09:00h.

z.Rexhep Gashi; Sa i përket kësaj pike mendoj që Sekretarinë Kuvendit e kemi të ngarkuar, sepse ka punuar te orari i të gjitha mbledhjeve, ku kemi Komitete të formuara më shumë se në legjislaturën e

kaluar. Unë mendoj se nëse nuk fuqizohet ky Komitet, nuk ka edhe arsyeje pse të ekzistojë. Sa i përket orarit të mbajtjes së mbledhjeve mua nuk me pengon fare le të mbetet ashtu si është propozuar.

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Unë punoj në arsim, dhe sa i përket orarit të mbajtjes së mbledhjeve e kisha lënë pas dite.

znj. Arbenita Brahimi; Përshëndetje, unë jam e mendimit me lënë në ora 14:00h e jo në 15:00h.

z. Hamëz Tërshani; Unë jam i mendimit ta kalojmë kështu si është, pastaj Kryesuesja vendos për secilin rast veç e veç.

*** Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi Vendim për e caktimit të orarit të mbledhjeve të KAKRS-së për vitin 2022, me propozimin që mbledhjet të mbahen në ora 10:00h.**

Pika 3

Draft- Plani i punës të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Arbenita Brahimi; Unë po bëjë pyetje, se a mbetet informata e arsimit për muajin Nëntor. Unë po propozoj që kjo informatë të kalojë në muajin Shtatorë.

z. Asllan Beqaj; Sa i përket Draft-Planit të punës të Komiteti është kohë e shkurt që na ka ardhur, dhe nuk kemi pas mundësi me e përpunuar. Propozoj që në muajin e ardhshëm me i pas pikat për shtator.

z. Rexhep Gashi; Kemi vetëm edhe tre muaj punë që i përkasin Planit të Punës. Unë mendoj që nuk mundet me pas informatë nga DKA-ja për garat sportive. Sa i përket transportit të nxënësve e kemi për fshatin Pjetërshicë, Petrovë dhe Mollopolc. Unë mendoj se ne duhet të diskutojmë për transportin që kryhet me operator privat, por duhet të mendohet edhe për transportin e nxënësve në rrugën "Ibrahim Rugova". Sa i përket raportit të OJQ-ve në Plan të Punës, unë nuk e di se qysh e kanë menduar këtë raport, sepse OJQ-të marrin subvencione dhe funksionojnë me parat e veta.

znj. Arbenita Brahimi; Unë e ceka punën e informatës se a me transferuar, apo me lënë veç ne muajin Nëntor, sepse mendoj që është me rëndësi.

z. Hamëz Tërshani; Muaji Gusht ka shkuar, tani ne duhet me bë një fuzionim të pikave të rendit të ditës, unë propozoj që pika e 7 në muajin Gusht të hiqet. Pika 1 dhe 2 e muajit Gusht me u bartë në muajin Shtator, por edhe pika e 7.

znj. Arbenita Brahimi; Pikën 1 nuk po e shoh të arsyeshme me e bartë, sepse veç ja kemi nisë shkollës. Kështu që unë propozoj që pikat 2, 3, 4 dhe 6 të muajit Gusht të kalojnë në muajin Shtator.

z. Asllan Beqaj; Unë propozoj që vetëm pikat 3, 4 dhe 6 të muajit Gusht të me u bartë në Shtator.

z. Rexhep Gashi; Pika 2 është e njëjta me pikën 3 të muajit Shtatorë.

z. Hamëz Tërshani; Unë jam i pajtimit me këto 3 pikat që të barten në muajin shtatorë.

z. Asllan Beqaj; Te muaji Shtatorë duhet ti heqim disa pika, sepse po bëhen shumë, kështu që propozoj që pikat me numër 4 dhe 5 të muajit Shtatorë me u bartur në muajin Tetorë.

*** Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi planin e punës për vitin 2022, me propozimet që pikat 3, 4 dhe 6 të kalojnë nga muajin Gusht në muajin Shtator, dhe pikat 4 dhe 5 të muajit Shtator të kalojnë në muajin Tetor 2022.**


Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 15:59h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Albana Podvorica

